



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 19 nëntor 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillimet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: tetor 2021

- Në tetor të vitit 2021, **paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})**, shënoi rënie mujore prej 0,5%, e cila në masë më të madhe është si rezultat i rënies të parave të depozituara³, ndërsa në masë më të vogël të depozitave afatgjata deri në dy vjet dhe parasë në qarkullim, në kushte të rritjes së depozitave afatshkurtra. Rritja vjetore e parasë të gjerë është 9,7% dhe kryesisht rezulton nga rritja e parave të depozituara dhe depozitave afatshkurtra, me rritje më të ulët të parasë në qarkullim dhe të depozitave afatgjata deri në dy vjet.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive^{4,5} të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	9.2021	10.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	9.2021	10.2021	9.2021	10.2021
Парина маса M4	455,834	468,912	469,050	486,989	507,536	505,157	8.9	9.8	6.9	6.9	8.2	7.8	-0.7	-0.5
Парина маса M3	403,714	416,935	418,556	436,231	460,723	458,578	8.3	9.7	7.6	8.0	10.1	9.7	-0.7	-0.5
<i>од кои:</i>														
Готови пари во оптек	37,891	41,125	41,667	43,701	44,951	44,699	21.3	26.3	24.9	21.0	7.9	6.6	0.9	-0.6
Вкупни депозiti	409,200	418,916	418,644	434,915	453,469	451,580	8.3	8.4	6.1	5.9	8.3	8.1	-0.8	-0.4
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	108,138	110,550	112,505	123,212	130,048	127,992	12.5	11.2	8.0	10.1	15.6	13.9	-2.8	-1.6
<i>Во денари</i>	75,876	77,609	79,641	86,323	87,402	85,602	13.8	9.3	5.4	5.4	9.7	8.8	-4.0	-2.1
<i>Во странска valuta</i>	32,261	32,941	32,865	36,889	42,646	42,390	9.5	15.9	14.9	22.8	29.8	25.9	-0.2	-0.6
Домајинства	275,574	280,512	278,469	285,216	297,702	297,787	8.6	8.7	6.1	4.6	6.9	7.2	0.5	0.0
<i>Во денари</i>	147,532	149,204	145,806	150,991	154,062	150,463	11.9	10.1	6.2	3.3	5.7	4.0	-0.2	-2.3
<i>Во странска valuta</i>	128,042	131,309	132,663	134,225	143,640	147,324	5.1	7.1	6.0	6.2	8.3	10.7	1.2	2.6
Вкупни krediti	343,702	352,718	352,824	357,296	375,116	377,466	5.8	6.6	7.3	4.7	6.3	6.7	0.7	0.6
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	167,654	172,978	168,086	169,826	176,093	177,363	1.8	4.6	5.2	1.1	4.8	5.6	0.6	0.7
<i>Во денари</i>	103,597	106,688	101,925	102,688	107,485	109,049	0.4	3.3	2.7	-0.9	5.5	6.7	0.5	1.5
<i>Во странска valuta</i>	64,057	66,290	66,161	67,138	68,608	68,314	4.0	6.9	9.3	4.3	3.7	4.1	0.7	-0.4
Домајинства	174,634	178,384	183,431	185,814	197,127	198,190	10.1	8.8	9.5	8.0	7.5	7.3	0.8	0.5
<i>Во денари</i>	96,643	99,469	103,939	105,049	111,470	112,216	8.8	8.7	12.0	10.5	7.2	6.9	0.9	0.7
<i>Во странска valuta</i>	77,990	78,916	79,492	80,765	85,657	85,974	11.9	8.9	6.4	5.0	7.8	7.9	0.8	0.4

Burimi: BPRMV.

¹ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

² Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

³ Paratë e depozituara i referohen llogarive rrjedhëse në banka dhe shtëpi kursimesh dhe llogarive rrjedhëse të institucioneve tjera financiare në Bankën Popullore


⁴ Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 janë nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vjet.

⁵ Të dhënat për agregatët monetarë, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar procedurë falimentimi.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në muajin tetor, **totali i depozitave**⁶ shënoi rënie mujore prej 0,4%, e cila shpjegohet plotësisht me rënien e depozitave të sektorit të korporatave. Në bazë vjetore, totali i depozitave u rrit për 8,1%, në të dy sektorët, e cila është më e theksuar në sektorin "amvisëri".
- Në muajin tetor, **totali i kredive**⁷ shënoi rritje mujore prej 0,6%, si rezultat i rritjes së kredive në të dy sektorët, me kontribut më të madh të sektorit të korporatave. Rritja vjetore e totalit të kredive është 6,7%, kryesisht nga rritja e kredive në sektorin "amvisëri".



Burimi: BPRMV

1. Depozitat dhe kreditë të sektorit të korporatave⁸



Burimi: BPRMV

⁶ Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshira në agregatin monetar M4.



⁷ Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t'i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndeje këto krahasime janë ndërprerë.

⁸ Për qëllimet e këtij njoftimi, sektori i korporatës përfshin korporatat jofinanciare publike dhe korporata jofinanciare private



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në muajin tetor, **totali i depozitave të sektorit të korporatave** shënoi rënie mujore prej 1,6%. Pra, rënia në masë të madhe është rezultat i rënies së parave të depozituara, depozitave afatshkurtra në denarë dhe depozitave afatgjata në valutë të huaj, me kontribut më të ulët të komponentëve të tjerë. Në bazë vjetore u shënuar rritje prej 13,9%, si rezultat i rritjes të parave të depozituara, depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në valutë të huaj, në kushte të rënies së depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në denarë.
- Në tetor, **kreditë e sektorit të korporatave**⁹, shënuan rritje mujore prej 0,7%, plotësisht si rezultat i rritjes së kreditimit në denarë, në kushte të rënies së kredive të miratuara në valutë të huaj. Analizuar në bazë vjetore, kreditë e sektorit të korporatave janë rritur për 5,6%, nën ndikimin e rritjes së kreditimit në denarë dhe në valutë të huaj, me kontribut më të theksuar të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive¹⁰



Burimi: BPRMV



⁹ Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

¹⁰Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në muajin tetor, **totali i depozitave të amvisërive** mbetet i pandryshuar në bazë mujore, ndërsa në bazë vjetore është rritur për 7,2%. Rritja është rezultat i depozitave afatshkurtra në valutë të huaj dhe parave të depozituara, me rritje më të ulët të depozitave afatgjata në valutë të huaj, ndërsa depozitat në denarë (afatgjata dhe afatshkurtra) shënuan rënie.
- Këtë muaj, tek **kreditë e amvisërive**, është shënuar rritje mujore dhe vjetore prej përkatësisht 0,5 dhe 7,3%. Analizuar sipas strukturës valutore, kreditë në denarë kanë kontribut më të madh në rritjen në të dyja bazat.





Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Tabela 2. Kreditë të bankave dhe shtëpive të kursimit të miratuara për personat fizik, sipas qëllimit të përdorimit

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	9.2021	10.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	9.2021	10.2021	9.2021	10.2021
Потрошувачки кредити	93,440	94,982	97,850	98,772	103,902	104,384	13.5	10.0	9.9	6.9	6.2	6.3	0.6	0.5
Станбени кредити	52,959	54,392	55,985	58,306	65,006	65,648	13.9	13.8	14.0	13.6	16.1	16.0	1.5	1.0
Автомобилски кредити	306	292	291	282	242	243	-4.1	-8.6	-7.9	-10.9	-16.9	-14.1	2.4	0.7
Кредитни картички	11,570	11,508	11,649	11,205	10,378	10,330	-4.5	-4.2	-2.6	-6.1	-10.9	-10.8	-0.5	-0.5
Негативни салда по тековни сметки	6,499	6,205	6,280	5,818	6,470	6,570	-4.8	-9.4	-10.8	-5.0	3.0	1.3	3.4	1.5
Други кредити	3,969	3,946	3,912	3,871	2,766	2,729	-6.7	-6.4	-6.7	-6.0	-29.3	-29.8	-3.5	-1.3

Burimi: BPRMV.

- Në tetor, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizik, **kreditë konsumatore dhe të strehimit**, si kategori më të përfaqësuara, shënuan rritje mujore prej përkatësisht 0,5% dhe 1,0%, si dhe rritje vjetore prej përkatësisht 6,3% dhe 16,0%. **Kreditë për automjete** në muajin tetor janë rritur me 0,7% në bazë mujore, ndërsa në bazë vjetore janë më të ulëta për 14,1%. Këtë muaj, kreditë të miratuara në **kartela kreditore** shënuan rënie mujore dhe vjetore prej përkatësisht 0,5% dhe 10,8%. Në tetor, **bilanci negativ në llogaritë rrjedhëse (minusi i miratuar)**, u rrit për 1,5% dhe 1,3%, në bazë mujore dhe vjetore, ndërsa kreditë e miratuara në **baza tjera** shënuan rënie mujore dhe vjetore prej përkatësisht 1,3% dhe 29,8%.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Bilansi dhe pasqyra e institucioneve depozituese, të dhëna mujore:

http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nspk

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Methodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave:

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 dhjetor të vitit 2021 (mesatare referuese duke përfshirë muajin nëntor 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).